



Nr.08/1 Prot

Datë 08.05.2026

**KËRKESË
PËR NDËRHYRËS KRYESOR NË GJYKIM**

Kërkues: Shoqata "Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë", themeluar me vendimin me Nr 7685 datë 28.01.2026 me kryetar Gjergji Zefi, me adresë: *Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Don Bosko", Kulla nr. 2, Zyra nr.7, kati parë, Tiranë.*

Objekti: Kërkesë për ndërhyrës kryesor në çështjen me palë paditës: *Eriona Veliaj, I Paditur: Prokurorin Olsi Dado dhe subjekte të tjera të interesuara, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjes/emërimit të Olsi Dados në funksionin e prokurorit.*

Baza Ligjore: Neni 189 e vijues të Kodit të Proçedurës Civile

Drejtuar : Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Gjyqtar Hazbi Balliu

I Nderuar,

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është duke u gjykuar çështja administrative me palë paditëse **Erjon Veliaj**, me palë të paditur **Prokurorin Olsi Dado** dhe subjekte të tjera të interesuara, me objekt **konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjes/emërimit të Olsi Dados në funksionin e prokurorit.**

Kjo çështje, për nga natyra dhe objekti i saj, nuk përbën një mosmarrëveshje të zakonshme administrative, të kufizuar vetëm në raportin ndërmjet palëve formale të procesit, por prek drejtpërdrejt një interes të lartë public, **ligjshmërinë e zgjedhjes së një funksionari të organit të akuzës**, integritetin e sistemit të drejtësisë, besimin e publikut te prokuroria dhe standardin e përgjegjshmërisë së institucioneve që vendosin mbi karrierën e prokurorëve. Në këtë proces pretendohet dhe provohet se zgjedhja e Olsi Dados si prokuror është kryer në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, transparencës, meritokracisë, barazisë në konkurrim dhe funksionimit të rregullt të organeve të drejtësisë. Për këtë arsye, objekti i gjykimit nuk ka rëndësi vetëm për statusin individual të një prokurori, por edhe për pasojat që një zgjedhje e tillë sjell mbi ushtrimin e pushtetit penal, mbi vlefshmërinë institucionale të vendimmarrjes së

prokurorit dhe mbi besimin e qytetarëve se drejtësia ushtrohet nga funksionarë të zgjedhur në mënyrë të ligjshme. Rëndësia publike e kësaj çështjeje bëhet edhe më e theksuar për faktin se Olsi Dado është caktuar dhe ka ushtruar funksione si prokuror në çështjen e njohur të **21 Janarit**, një nga ngjarjet më të rënda në historinë e drejtësisë shqiptare, ku humbën jetën katër qytetarë dhe ku shteti shqiptar ka pasur detyrimin më të lartë për të garantuar një hetim të plotë, të pavarur, efektiv dhe proceduralisht të rregullt. Në këto kushte, çështja objekt gjykimi merr një dimension më të gjerë se sa vetë pavlefshmëria e aktit të zgjedhjes. Ajo lidhet me pyetjen nëse një funksionar i organit të akuzës, i zgjedhur në mënyrë të kontestuar dhe të pretenduar si të paligjshme, mund të ushtrojë kompetenca në çështje me rëndësi madhore publike, me pasoja për jetën, të drejtat e viktimave, interesin publik dhe besimin te drejtësia. Pikërisht për këtë arsye, Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, duke qenë një subjekt që ka në objektin e veprimtarisë së saj mbrojtjen e drejtësisë së pavarur, denoncimin e shkeljeve institucionale, nxitjen e transparencës, përgjegjshmërisë së pushtetit, mbrojtjen e lirisë së medias dhe të drejtës së publikut për informim, ka interes të drejtpërdrejtë, të ligjshëm dhe të posaçëm për të ndërhyrë në këtë proces gjyqësor si **ndërhyrëse kryesore**.

Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, ka interes të drejtpërdrejtë, të ligjshëm, aktual, real dhe të posaçëm për të hyrë në këtë proces gjyqësor administrativ si **ndërhyrëse kryesore**, pasi objekti i gjykimit nuk kufizohet vetëm në një marrëdhënie individuale administrative ndërmjet paditësit dhe palës së paditur, por lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me një çështje me rëndësi të lartë publike, **ligjshmërinë e zgjedhjes së një prokurori të Republikës së Shqipërisë**, i cili ushtron pushtet penal në emër të shtetit dhe ka kompetenca që prekin drejtpërdrejt të drejtat, liritë, jetën, dinjitetin, sigurinë juridike dhe besimin publik të qytetarëve te sistemi i drejtësisë. Në këtë proces gjyqësor administrativ kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjes së Olsi Dados si prokuror. Ky objekt, për nga natyra e tij, nuk është thjesht një çështje e karrierës individuale të një funksionari publik. Ai prek në themel mënyrën se si ndërtohet legjitimiteti i organit të akuzës, mënyrën se si garantohet integriteti i prokurorëve, si dhe standardin minimal që duhet të respektojë shteti kur i jep një personi kompetencën për të hetuar, akuzuar, kufizuar të drejtat e qytetarëve dhe ndikuar në fatin e proceseve penale. Pikërisht për këtë arsye, Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, ka interes të ndërhyjë në proces, pasi sipas objektit të veprimtarisë së saj, ajo është krijuar për të mbrojtur dhe promovuar **lirinë e shprehjes, të drejtat e medias dhe drejtësinë**, si dhe për të kontribuar në sigurimin e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të paanshëm. Në objektin e saj parashikohet gjithashtu angazhimi për denoncimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë së pavarur, për hartimin e analizave dhe opinionëve juridike mbi çështje me interes publik, për zhvillimin e projekteve që nxisin transparencën institucionale dhe përgjegjshmërinë e pushtetit, si dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe gazetarëve investigativë që denoncojnë korrupsionin dhe keqpërdorimin e pushtetit. Nga ky këndvështrim, çështja objekt gjykimi hyn në mënyrë të natyrshme dhe të drejtpërdrejtë në fushën e veprimtarisë së Shoqatës. Kur kontestohet zgjedhja e një prokurori si e paligjshme, e padrejtë ose e kryer në shkelje të kriterëve ligjore, nuk kemi të bëjmë vetëm me cenimin e një procedure administrative të zakonshme. Kemi të bëjmë me cenimin e standardit të drejtësisë së pavarur, me cenimin e besimit publik te organi i akuzës dhe me rrezikun që pushteti penal i shtetit të jetë ushtruar nga një funksionar, statusi i të cilit nuk është krijuar në mënyrë të ligjshme.

Prokurori është një nga figurat më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë penale. Ai vendos mbi fatin e kallëzimeve penale, mbi regjistrimin ose mosregjistrimin e procedimeve, mbi drejtimin e hetimeve, mbi marrjen dhe administrimin e provave, mbi kërkimin e masave të sigurimit, mbi ngritjen ose mosngritjen e akuzës, mbi pushimin ose vijimin e procedimit penal dhe mbi përfaqësimin e akuzës në gjykatë. Për rrjedhojë, nëse një person zgjidhet prokuror në mënyrë të paligjshme, çdo veprim i tij në ushtrimin e funksionit të prokurorit merr një rëndësi të veçantë publike dhe juridike, sepse prek drejtpërdrejt qytetarët, viktimat, të pandehurit, familjarët e viktimave dhe interesin e shoqërisë për drejtësi. Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, ka interes të posaçëm në këtë proces, sepse misioni i saj nuk është vetëm të flasë në mënyrë abstrakte për drejtësinë, por të ndërhyjë në ato raste ku drejtësia, pavarësia institucionale dhe transparenca cenohen në mënyrë konkrete. Në rastin objekt gjykimi, pretendohet se Olsi Dado është zgjedhur në mënyrë të padrejtë si prokuror. Nëse ky pretendim provohet, atëherë kemi një cenim të rëndë jo vetëm të procedurës së zgjedhjes, por edhe të parimit të ligjshmërisë, meritokracisë, barazisë së kandidatëve, transparencës dhe besueshmërisë së organit të prokurorisë. Për këtë arsye, ndërhyrja e Shoqatës nuk është ndërhyrje formale, mediatike apo jashtme ndaj objektit të gjykimit. Përkundrazi, ajo është një ndërhyrje që buron drejtpërdrejt nga objekti i saj statutor dhe nga qëllimi për të mbrojtur drejtësinë e pavarur dhe interesin publik. Shoqata ka interes që në sistemin e drejtësisë të mos ushtrojnë funksione persona të zgjedhur në shkelje të ligjit. Ajo ka interes që organet e drejtësisë të jenë të përbëra nga funksionarë të zgjedhur në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të pakontestueshme. Ajo ka interes që publiku të mos vendoset përballë vendimmarrjeve penale të kryera nga funksionarë me legjitimitet të cenuar.

Një nga pikat kryesore të objektit të Shoqatës është **zbulimi dhe denoncimi i shkeljeve të lirisë së shprehjes, të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë së pavarur**. Kjo pikë lidhet drejtpërdrejt me çështjen konkrete. Zgjedhja e padrejtë e një prokurori, nëse provohet, është shkelje që godet drejtësinë e pavarur në bazën e saj. Drejtësia e pavarur nuk cenohet vetëm kur një gjyqtar ose prokuror urdhërohet nga politika, por edhe kur vetë mekanizmi i përzgjedhjes së tij devijohet nga ligji, nga meritokracia dhe nga kriteret objektive. Një prokuror i zgjedhur në mënyrë të padrejtë nuk e ka të plotë legjitimitetin institucional për të ushtruar pushtet penal mbi qytetarët. Në këtë kuptim, Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, ka interes të ndërhyjë për të denoncuar para gjykatës një situatë që, sipas pretendimeve të ngritura në proces, përbën cenim të drejtësisë së pavarur dhe të ligjshmërisë institucionale. Kjo është pikërisht ajo që parashikon objekti i saj: të mos qëndrojë pasive përballë shkeljeve që dëmtojnë drejtësinë, por të përdorë mjetet juridike dhe publike për të kërkuar rivendosjen e standardeve të ligjshmërisë. Interesi i Shoqatës forcohet ndjeshëm nga fakti se Olsi Dado është caktuar edhe si prokuror në çështjen e njohur të **21 Janarit**, një nga çështjet më të rënda në historinë e drejtësisë shqiptare, ku humbën jetën katër qytetarë. Kjo çështje nuk është një çështje e zakonshme penale. Ajo është çështje e jetës, e përgjegjësisë shtetërore, e përdorimit të forcës nga institucionet, e të drejtës së familjarëve të viktimave për hetim efektiv dhe e detyrimit të shtetit për të siguruar drejtësi të vërtetë, të plotë dhe të paanshme.

Në një çështje të tillë, çdo dyshim mbi statusin, ligjshmërinë e emërimit ose integritetin procedural të prokurorit merr rëndësi të jashtëzakonshme. Nëse prokurori që ka trajtuar ose ndikuar në një çështje me katër viktime është zgjedhur në mënyrë të padrejtë, atëherë kjo nuk mund të trajtohet si një e metë e izoluar administrative. Kjo ngre çështje serioze mbi besueshmërinë e hetimit, mbi

vlefshmërinë morale dhe institucionale të veprimeve të kryera, mbi standardin e kujdesit procedural dhe mbi faktin nëse drejtësia për viktimat është trajtuar nga një autoritet me legjitimitet të plotë ligjor. Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, ka interes të mbrojtë parimin se çështje të tilla, ku janë vrarë qytetarë dhe ku shteti ka detyrimin më të lartë për të hetuar në mënyrë efektive, nuk mund të administrohen nga funksionarë të drejtësisë për të cilët ekzistojnë dyshime serioze mbi mënyrën e zgjedhjes. Në një shoqëri demokratike, drejtësia për ngjarje me viktima dhe me rëndësi të lartë publike nuk mund të jetë thjesht formale. Ajo duhet të jetë e ligjshme në çdo hallkë: në përzgjedhjen e prokurorit, në veprimet hetimore, në administrimin e provave, në respektimin e procedurës, në trajtimin e viktimave dhe në përfundimin e çështjes. Nëse një çështje si 21 Janari është dëmtuar proceduralisht nga veprimet ose mosveprimet e prokurorit, atëherë interesi i Shoqatës bëhet edhe më i fortë. Shoqata ka interes të kërkojë që gjykata të vlerësojë jo vetëm ligjshmërinë formale të aktit të zgjedhjes, por edhe rëndësinë publike që ka fakti se ky prokuror ka ushtruar funksione në çështje madhore. Një zgjedhje e paligjshme në një post të zakonshëm administrativ mund të prodhojë pasoja administrative. Por një zgjedhje e paligjshme në funksionin e prokurorit mund të prodhojë pasoja shumë më të rënda: cenim të hetimeve, dobësim të besimit publik, dëmtim të të drejtave të viktimave dhe relativizim të përgjegjësisë shtetërore.

Në këtë kontekst, interesi i Shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, bëhet edhe më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë, pasi çështja nuk lidhet vetëm me ligjshmërinë abstrakte të zgjedhjes së Olsi Dados si prokuror, por edhe me pasojat konkrete që ushtrimi i funksionit prej tij ka prodhuar në një nga çështjet më të rënda të drejtësisë shqiptare, atë të **21 Janarit**. Çështja e 21 Janarit nuk është një çështje e zakonshme penale, por një ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme publike, shoqërore dhe institucionale, ku humbën jetën katër qytetarë dhe ku shteti shqiptar kishte detyrimin më të lartë ligjor, kushtetues dhe konventor për të garantuar një hetim të plotë, të pavarur, efektiv dhe të pandikuar. Ky detyrim nuk ishte thjesht formal, por buronte nga vetë e drejta për jetën dhe nga nevoja që përdorimi i forcës shtetërore të hetohet me standard maksimal. Rëndësia e kësaj çështjeje është konfirmuar jo vetëm nga debati publik dhe institucional në Shqipëri, por edhe nga vendimmarrja ndërkombëtare. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen **Nika kundër Shqipërisë**, ka konstatuar shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në aspektin substancial dhe procedural të së drejtës për jetën, duke theksuar se hetimi për vdekjen e Aleks Nikës nuk kishte përmbushur standardin e një hetimi efektiv. Në materialin zyrtar të Gjykatës Evropiane evidentohet se autoritetet shqiptare mbanin përgjegjësi për vdekjen e A.N. dhe se ankimi lidhet pikërisht me përdorimin e tepruar të forcës dhe me mungesën e një hetimi efektiv. Ky konstatim i Gjykatës së Strasburgut e zhvendos çështjen e 21 Janarit nga niveli i një debati të zakonshëm procedural në nivelin e një dështimi institucional të shtetit për të hetuar në mënyrë efektive një ngjarje ku u cenua e drejta për jetën. Për rrjedhojë, çdo funksionar i drejtësisë që ka pasur rol në këtë çështje duhet të jetë i pakontestueshëm në legjitimitetin e tij, në mënyrën e zgjedhjes, në integritetin procedural dhe në aftësinë për të garantuar një hetim të pavarur e të plotë. Në rastin konkret, fakti që Olsi Dado, zgjedhja e të cilit si prokuror kontestohet në këtë proces si e padrejtë dhe e paligjshme, ka qenë njëkohësisht i përfshirë në trajtimin e çështjes së 21 Janarit, e bën interesin e Shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, edhe më të fortë. Nuk kemi të bëjmë më vetëm me një akt administrativ të zgjedhjes së një prokurori, por me pasojat që një zgjedhje e tillë ka sjellë mbi një çështje ku janë konstatuar mangësi serioze në hetim dhe ku standardi i kërkuar nga e drejta kombëtare dhe ajo

evropiane ka qenë maksimal. Nëse një çështje me katër viktimë, e lidhur me përdorimin e forcës shtetërore dhe me detyrimin e shtetit për hetim efektiv, është dëmtuar proceduralisht, atëherë kjo nuk mund të ndahet nga cilësia, statusi dhe ligjshmëria e funksionarëve që e kanë administruar atë. Një prokuror i zgjedhur në mënyrë të paligjshme ose të padrejtë nuk mund të konsiderohet thjesht problem individual i sistemit të karrierës, por faktor që cenon vetë besueshmërinë e veprimeve procedurale të kryera prej tij në çështje me rëndësi madhore publike. Pikërisht ky element krijon lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet objektit të Shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë” dhe objektit të çështjes gjyqësore. Shoqata, në objektin e saj, ka parashikuar mbrojtjen e drejtësisë së pavarur, denoncimin e shkeljeve të drejtësisë, nxitjen e transparencës institucionale, përgjegjshmërinë e pushtetit, mbrojtjen e lirisë së medias dhe mbështetjen e atyre që denoncojnë korrupsionin dhe keqpërdorimin e pushtetit. Në një çështje ku Gjykata e Strasburgut ka konstatuar dështim të hetimit efektiv për vrasjen e një qytetari, ndërhyrja e një shoqate që ka pikërisht këtë objekt nuk është vetëm e ligjshme, por e domosdoshme. Shoqata ka interes të mbrojë parimin se hetimi i një ngjarjeje si 21 Janari nuk mund të administrohet, të zvarritet, të dobësohet apo të dëmtohet nga funksionarë të drejtësisë, legjitimiteti i të cilëve është vetë objekt kontestimi gjyqësor. Nëse drejtësia për një ngjarje ku kanë humbur jetën qytetarë deformohet nga shkelje procedurale, mungesë hetimi efektiv apo vendimmarrje të pambështetura në standardet e ligjit, atëherë shoqëria civile ka jo vetëm të drejtë, por edhe detyrim moral dhe institucional të ndërhyjë për të kërkuar rivendosjen e ligjshmërisë. Në këtë kuptim, çështja e 21 Janarit tregon se pasojat e zgjedhjes së padrejtë të një prokurori nuk mbeten në letër. Ato mund të materializohen në dëmtimin e çështjeve penale me rëndësi të jashtëzakonshme, në humbjen e besimit të familjarëve të viktimave, në dobësimin e përgjegjësisë shtetërore dhe në krijimin e perceptimit se krimet me autoritet shtetëror mund të mbulohen përmes zvarritjes, fragmentimit ose deformimit procedural të hetimit. Për këtë arsye, Shoqata Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë” ka interes të posaçëm që të ndërhyjë si ndërhyrëse kryesore në këtë proces, për të kërkuar që gjykata ta vlerësojë çështjen jo vetëm në aspektin formal të aktit të zgjedhjes së prokurorit, por edhe në funksion të pasojave që ky akt ka sjellë në drejtësi. Kur një prokuror i zgjedhur në mënyrë të kontestuar ka qenë i përfshirë në një çështje ku Gjykata e Strasburgut ka konstatuar dështim të hetimit efektiv, atëherë interesi publik për kontroll gjyqësor bëhet shumë më i lartë. Në këto kushte, pranimi i Shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, si ndërhyrëse kryesore i shërben transparencës, përgjegjshmërisë dhe kontrollit demokratik mbi organet e drejtësisë. Ai i jep mundësi gjykatës të vlerësojë jo vetëm interesin individual të palëve, por edhe interesin publik që lidhet me funksionimin e drejtësisë në çështje ku janë cenuar të drejtat më themelore të njeriut. Një çështje ku Gjykata Evropiane ka konstatuar shkelje të së drejtës për jetën dhe mungesë hetimi efektiv nuk mund të trajtohet si çështje e zakonshme administrative, sidomos kur në qendër të saj ndodhet ligjshmëria e zgjedhjes së një prokurori që ka pasur rol në këtë dosje.

Një tjetër pikë e rëndësishme e objektit të Shoqatës është **promovimi i transparencës institucionale dhe përgjegjshmërisë së pushtetit**. Zgjedhja e prokurorëve është një akt i pushtetit publik. Ajo nuk mund të mbetet jashtë kontrollit të ligjshmërisë dhe transparencës. Institucionet që zgjedhin, emërojnë apo promovojnë prokurorë nuk veprojnë në një hapësirë private. Ato administrojnë pushtet publik dhe duhet të japin llogari për mënyrën se si zbatojnë ligjin, si vlerësojnë kandidatët, si respektojnë kriteret dhe si garantojnë barazinë në konkurrim. Për këtë arsye, Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë” ka interes të ndërhyjë në proces për të mbrojtur parimin se çdo akt që lidhet me zgjedhjen e prokurorëve duhet të jetë i

verifikueshëm, i motivuar, transparent dhe i kontrollueshëm gjyqësisht. Nëse një prokuror është zgjedhur në mënyrë të padrejtë, atëherë kemi jo vetëm një shkelje ndaj kandidatëve të tjerë, por edhe një shkelje ndaj publikut, i cili ka të drejtë të dijë se funksionarët e drejtësisë nuk janë produkt i parregullsive, favorizimeve, ndërhyrjeve apo shkeljeve procedurale. Në këtë drejtim, ndërhyrja e Shoqatës lidhet drejtpërdrejt me përgjegjshmërinë e pushtetit. Prokuroria dhe organet që lidhen me statusin e prokurorëve janë pjesë e pushtetit publik. Ato kanë detyrim të respektojnë ligjin në mënyrë rigorozë, sepse janë institucione që vetë kërkojnë zbatimin e ligjit nga qytetarët. Nuk mund të ketë organ akuze që kërkon përgjegjësi penale nga qytetarët, ndërkohë që vetë brenda tij tolerohen procedura të paligjshme për zgjedhjen e funksionarëve. Shoqata ka interes të ngrejë para gjykatës pikërisht këtë standard, **drejtësia nuk mund të kërkojë ligjshmëri nga qytetarët nëse nuk është vetë produkt i ligjshmërisë.** Një prokuror i zgjedhur në shkelje të ligjit cenon autoritetin moral dhe juridik të organit të akuzës. Prandaj, procesi për pavlefshmërinë e zgjedhjes së tij është proces me rëndësi publike dhe jo thjesht konflikt individual. Një tjetër element i objektit të Shoqatës është **hartimi dhe publikimi i opinioneve juridike dhe analizave mbi çështje me interes publik.** Kjo pikë i jep Shoqatës një rol aktiv në debatet juridike që lidhen me funksionimin e drejtësisë. Shoqata nuk është krijuar vetëm për të shprehur qëndrime publike, por edhe për të kontribuar me analizë juridike në çështje ku ligjshmëria, të drejtat e njeriut, transparenca dhe përgjegjshmëria institucionale janë në diskutim. Çështja konkrete është pikërisht e tillë. Ajo kërkon një vlerësim jo vetëm formal të aktit administrativ të zgjedhjes, por edhe një analizë të pasojave që sjell zgjedhja e padrejtë e një prokurori në sistemin e drejtësisë.

Shoqata, në cilësinë e ndërhyrëses kryesore, mund t'i paraqesë gjykatës argumente juridike mbi lidhjen ndërmjet ligjshmërisë së emërimit dhe pavarësisë së drejtësisë, mbi ndikimin që ka një zgjedhje e paligjshme në besimin publik, mbi rëndësinë që ka integriteti i prokurorit në çështje penale madhore, si dhe mbi nevojën që organet e drejtësisë të mos jenë vetëm të pavarura në dukje, por edhe të ligjshme në origjinën e funksionarëve të tyre. Në këtë proces, Shoqata nuk kërkon të mbështesë palën paditëse. Ajo ka një interes të vetin, të pavarur dhe të dallueshëm. Interesi i paditësit mund të lidhet me pavlefshmërinë e zgjedhjes së prokurorit për arsye të caktuara administrative. Ndërsa interesi i Shoqatës lidhet me mbrojtjen e standardit publik të drejtësisë, me transparençën e zgjedhjes së prokurorëve, me përgjegjshmërinë institucionale dhe me pasojat që një emërim i paligjshëm sjell për çështje të interesit madhor, përfshirë çështjen e 21 Janarit. Kjo e bën ndërhyrjen e saj **kryesore**, sepse ajo nuk është thjesht ndihmëse e njëjës palë, por paraqitet në proces për të mbrojtur një interes juridik të vetin, të lidhur me objektin e saj dhe me interesin publik. Një tjetër pikë që e forcon interesin e Shoqatës është **mbështetja juridike dhe ligjore për gazetarët dhe aktorët e drejtësisë në nevojë.** Kjo nuk duhet interpretuar ngushtë vetëm si mbrojtje individuale e një gazetari apo një funksionari drejtësie. Në kuptim më të gjerë, kjo pikë përfshin angazhimin e Shoqatës në procese ku aktorët e drejtësisë, integriteti i sistemit dhe e drejta e publikut për drejtësi të ligjshme janë në diskutim. Në rastin konkret, çështja prek vetë cilësinë e aktorit të drejtësisë, nëse prokurori është zgjedhur ligjërisht apo jo. Nëse një aktor i drejtësisë ka hyrë në sistem në mënyrë të padrejtë, atëherë kjo dëmton edhe ata aktorë të drejtësisë që respektojnë ligjin, që përmbushin kriteret dhe që nuk favorizohen nga procedura të deformuara. Shoqata ka interes të mbrojë edhe këtë dimension të drejtësisë: mbrojtjen e profesionistëve të ndershëm të sistemit nga deformimet, favorizimet dhe paligjshmëritë që ulin standardin e institucionit. Në këtë këndvështrim, ndërhyrja e Shoqatës synon të mbrojë edhe parimin e konkurrencës së ndershme në sistemin e drejtësisë. Zgjedhja e një prokurori nuk është vetëm akt

administrativ, por është akt që duhet të reflektojë meritë, integritet, profesionalizëm dhe respektim të ligjit. Nëse këto standarde nuk janë respektuar, atëherë cenohet i gjithë trupi profesional i prokurorëve dhe dëmtohet besimi i qytetarëve se drejtësia përfaqësohet nga më të mirët dhe nga ata që kanë kaluar procedura të rregullta.

Shoqata ka interes edhe për shkak të lidhjes së çështjes me **lirinë e shprehjes dhe të drejtën e publikut për informim**. Liria e medias nuk kufizohet vetëm te e drejta e gazetarit për të shkruar. Ajo përfshin edhe të drejtën e publikut për të marrë informacion mbi funksionimin e institucioneve të drejtësisë, mbi emërimin e prokurorëve, mbi çështjet penale me rëndësi publike dhe mbi arsyet pse procese të caktuara dështojnë, vonohen ose deformohen. Çështja e 21 Janarit ka qenë dhe mbetet objekt i interesit të lartë publik dhe mediatic. Prandaj, çdo proces që lidhet me prokurorin që ka trajtuar këtë çështje lidhet drejtpërdrejt edhe me të drejtën e publikut për t'u informuar. Shoqata "Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë", ka interes që çështjet e drejtësisë të mos mbeten të mbyllura pas një formalizmi institucional. Ajo ka interes që publiku të kuptojë nëse funksionarët e drejtësisë janë zgjedhur në përputhje me ligjin, nëse ata kanë pasur legjitimitetin e duhur për të ushtruar funksionin dhe nëse veprimet e tyre në çështje madhore janë kryer nga një autoritet i ligjshëm. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt me lirinë e medias, me transparencën dhe me debatin publik. Në objektin e Shoqatës parashikohet edhe mbrojtja e **sinjalizuesve dhe gazetarëve investigativë**, të cilët denoncojnë korrupsionin dhe keqpërdorimin e pushtetit. Kjo pikë ka rëndësi të posaçme në rastin konkret. Një procedurë e dyshuar si e paligjshme për zgjedhjen e një prokurori është pikërisht një fenomen që mund të zbulohet, hetohet, denoncohet dhe trajtohet nga media, gazetarët investigativë, sinjalizuesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Shoqata ka interes që këto denoncime të mos mbeten vetëm në nivel publik, por të marrin trajtim juridik dhe gjyqësor. Nëse një shoqatë me objekt mbrojtjen e medias dhe drejtësisë nuk do të kishte të drejtë të ndërhynte në një proces ku kontestohet zgjedhja e një prokurori, atëherë roli i saj do të reduktohej artificialisht dhe padrejtësisht. Objekti i saj do të mbetej deklarativ, pa mundësi për t'u ushtruar realisht në situatat ku cenimi i drejtësisë është konkret. Por qëllimi i objektit të shoqatës nuk është të prodhojë vetëm deklarata. Ai është të mundësojë veprim konkret për mbrojtjen e drejtësisë, transparencës dhe interesit publik.

Shoqata ka interes që të mbrojë edhe **sigurinë juridike**. Qytetarët kanë të drejtë të besojnë se prokurorët që trajtojnë çështjet e tyre janë të zgjedhur në mënyrë të ligjshme. Viktimat kanë të drejtë të besojnë se hetimi i çështjes së tyre kryhet nga një autoritet i rregullt. Të pandehurit kanë të drejtë të dinë se ndjekja penale ndaj tyre ushtrohet nga një prokuror me status të ligjshëm. Publiku ka të drejtë të besojë se çështjet me viktimat dhe me ndikim politik apo shoqëror nuk trajtohen nga funksionarë të emëruar në mënyrë të kontestuar. Këto janë elemente të sigurisë juridike dhe të shtetit të së drejtës. Në rastin e Olsi Dados, pretendimi se ai është zgjedhur në mënyrë të padrejtë, i kombinuar me faktin se ai ka qenë prokuror në çështjen e 21 Janarit, krijon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet objektit të gjykimit dhe interesit publik që mbron Shoqata. Nuk bëhet fjalë për një prokuror pa ndikim publik ose për një akt pa pasoja. Bëhet fjalë për një funksionar të organit të akuzës, i cili ka pasur rol në një çështje ku shteti shqiptar ka pasur detyrim të veçantë për të siguruar hetim efektiv, të pavarur dhe të plotë. Prandaj, Shoqata ka interes të kërkojë që gjykata të mos e trajtojë çështjen në mënyrë të ngushtë, por të kuptojë se pavlefshmëria e zgjedhjes së një prokurori ka dimension më të gjerë se vetë akti administrativ. Ajo lidhet me integritetin e sistemit, me efektivitetin e hetimit penal, me të drejtën e viktimave për drejtësi, me

detyrimin e shtetit për të garantuar organe të ligjshme akuze dhe me të drejtën e publikut për të pasur institucione të besueshme. Në këtë aspekt, interesi i Shoqatës është i ndryshëm nga një interes i përgjithshëm qytetar. Çdo qytetar mund të ketë shqetësim moral për çështjen. Por Shoqata ka interes të veçantë juridik, sepse objekti i saj e ngarkon me misionin për të vepruar në fushën e medias dhe drejtësisë, për të mbrojtur drejtësinë e pavarur, për të denoncuar shkeljet, për të promovuar transparencën, për të nxitur përgjegjshmërinë dhe për të mbështetur ata që zbulojnë abuzime. Kjo e dallon interesin e saj nga interesi i përgjithshëm i publikut.

Shoqata ka interes edhe për faktin se vendimi që do të jepet në këtë proces mund të krijojë një standard të rëndësishëm për të ardhmen. Nëse gjykata pranon ndërhyrjen e saj, ajo njeh rolin e shoqërisë civile në çështje ku drejtësia dhe interesi publik preken drejtpërdrejt. Nëse gjykata shqyrton në themel pretendimet për pavlefshmërinë e zgjedhjes së prokurorit, ajo forcon standardin se emërimet në drejtësi nuk janë akte të pakontrollueshme, por akte që duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe të hapura ndaj kontrollit gjyqësor. Përkundrazi, nëse një shkelje në zgjedhjen e prokurorit do të tolerohej për arsye formale, do të krijohej një precedent i rrezikshëm. Do të jepej mesazhi se edhe kur një prokuror zgjidhet në mënyrë të padrejtë, pasojat mund të mbeten të paprekura. Kjo do të dëmtonte rëndë besimin e publikut te drejtësia, do të dobësonte standardin e përgjegjshmërisë dhe do të krijonte idenë se sistemi mbron veten edhe kur është ndërtuar mbi shkelje. Shoqata "Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë", ka interes të kundërshtojë pikërisht këtë logjikë. Ajo ka interes të afirmojë se drejtësia fillon nga ligjshmëria e atyre që e ushtrojnë atë. Nuk mund të ketë hetim të drejtë nga një prokuror i zgjedhur padrejtësisht. Nuk mund të ketë besim publik në një organ akuze që toleron cenime në emërime. Nuk mund të ketë drejtësi efektive për viktimat nëse çështjet e tyre trajtohen nga funksionarë me status të dyshimtë. Nuk mund të ketë liri të medias dhe transparencë reale nëse shoqëria civile përjashtohet nga proceset ku verifikohet ligjshmëria e funksionarëve të drejtësisë.

Në planin procedural, Shoqata duhet të pranohet si **ndërhyrëse kryesore**, sepse ajo nuk paraqitet në proces vetëm për të përkrahur njërin palë. Ajo paraqitet për të mbrojtur një interes të vetin, të bazuar në objektin e saj statutor. Interesi i saj është i lidhur me objektin e padisë, sepse pavlefshmëria e zgjedhjes së prokurorit lidhet drejtpërdrejt me drejtësinë e pavarur, me ligjshmërinë e organeve të akuzës dhe me përgjegjshmërinë institucionale. Për këtë arsye, ndërhyrja nuk është aksidentale, por substanciale. Shoqata ka të drejtë të kërkojë që gjykata të vlerësojë se akti i zgjedhjes së Olsi Dados, nëse është kryer në kundërshtim me ligjin, duhet të shpallet i pavlefshëm, pasi një akt i tillë nuk mund të legjitimojë ushtrimin e mëtejshëm të një funksioni publik të rëndësishëm kaq të lartë. Nëse ligji është shkelur në momentin e krijimit të statusit të prokurorit, atëherë nuk mund të pretendohet se pasojat e mëvonshme janë të paprekshme nga kjo shkelje. Ligjshmëria e origjinës së funksionit është kusht për ligjshmërinë e ushtrimit të tij. Në këtë kuptim, çështja e zgjedhjes së Olsi Dados nuk është vetëm çështje e së kaluarës. Ajo ka pasoja aktuale dhe të ardhshme. Ajo ndikon në perceptimin publik mbi dosjet ku ai ka vepruar. Ajo ndikon në vlerësimin e standardit të organit të akuzës. Ajo ndikon në besimin e qytetarëve se prokurorët nuk emërohen mbi baza të paligjshme. Ajo ndikon në mënyrën se si media dhe shoqëria civile mund të kërkojnë llogaridhënie nga drejtësia. Gjithashtu, Shoqata ka interes të veçantë për shkak se çështja e 21 Janarit ka qenë dhe mbetet një çështje ku media, gazetarët investigativë dhe opinioni publik kanë luajtur rol të rëndësishëm në mbajtjen gjallë të kërkesës për drejtësi. Nëse drejtësia institucionale ka dështuar ose është dëmtuar proceduralisht, roli i medias dhe shoqërisë civile

bëhet edhe më i rëndësishëm. Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, është pikërisht një subjekt që lidh këto dy fusha: median dhe drejtësinë. Prandaj interesi i saj në këtë proces është i natyrshëm, i arsyeshëm dhe i domosdoshëm. Shoqata nuk ndërhyr për të zëvendësuar organet shtetërore, por për të kërkuar që ato të funksionojnë sipas ligjit. Ajo nuk ndërhyr për të paragjykuar gjykatën, por për t’i paraqitur asaj dimensionin publik dhe institucional të çështjes. Ajo nuk ndërhyr për të krijuar debat mediatik brenda procesit, por për të mbrojtur juridikisht parimet që përbëjnë objektin e saj, drejtësinë e pavarur, transparencën, përgjegjshmërinë, denoncimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e interesit publik. Në këtë kuadër, Shoqata ka interes të theksojë se pavlefshmëria e zgjedhjes së një prokurori nuk është një kërkim teknik. Është kërkim që lidhet me pastrimin institucional të sistemit nga akte të paligjshme. Është kërkim që lidhet me nevojën që drejtësia të mos jetë vetëm funksionale, por edhe legjitime. Është kërkim që lidhet me parimin se askush nuk mund të marrë pushtet publik në kundërshtim me ligjin dhe më pas të prodhojë pasoja ndaj qytetarëve sikur gjithçka të ishte e rregullt. Për këto arsye, pranimi i Shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, si ndërhyrëse kryesore do t’i shërbente një gjykimi më të plotë, më të thelluar dhe më të drejtë. Do t’i mundësonte gjykatës të dëgjojë jo vetëm interesin individual të palëve, por edhe interesin publik që lidhet me funksionimin e drejtësisë. Do të forconte transparencën e procesit. Do të rriste besimin se çështjet që prekin organin e akuzës nuk trajtohen në mënyrë të mbyllur. Do të njihte rolin e shoqërisë civile në mbrojtjen e shtetit të së drejtës. Në përfundim, Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, ka interes të ligjshëm, të drejtpërdrejtë dhe të posaçëm për të ndërhyrë në këtë proces si ndërhyrëse kryesore, sepse çështja objekt gjykimi lidhet drejtpërdrejt me objektin e saj statutor dhe me misionin e saj për mbrojtjen e drejtësisë së pavarur, denoncimin e shkeljeve institucionale, nxitjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë, mbështetjen e lirisë së medias dhe mbrojtjen e interesit publik. Zgjedhja e paligjshme e një prokurori, nëse provohet, nuk është thjesht shkelje administrative, por cenim i rëndë i besimit publik të drejtësia dhe i standardit që duhet të karakterizojë organin e akuzës.

Për më tepër, fakti që Olsi Dado ka qenë i lidhur me çështjen e 21 Janarit, një çështje me katër viktima dhe me rëndësi të jashtëzakonshme publike, e bën ndërhyrjen e Shoqatës edhe më të domosdoshme. Shoqata ka interes që gjykata të verifikojë me rigorozitet ligjshmërinë e zgjedhjes së tij, pasi çdo cenim në këtë drejtim reflekton mbi besueshmërinë e drejtësisë në çështje madhore, mbi të drejtën e viktimave për hetim efektiv dhe mbi të drejtën e publikut për një sistem drejtësie të ligjshëm, transparent dhe të përgjegjshëm. Prandaj, kërkesa e Shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, për t’u pranuar si **ndërhyrëse kryesore** duhet të pranohet, pasi ajo nuk bazohet në një interes abstrakt apo të përgjithshëm, por në një interes konkret juridik, të lidhur drejtpërdrejt me objektin e saj të veprimtarisë dhe me objektin e çështjes gjyqësore.

Për sa më sipër,

KËRKOJMË

- Pranimin e kërkesës shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”, si person i tretë në gjykim

Kryetari i shoqatës “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë”

Gjergji Zefi

9

Shoqata “Asociacioni Kombëtar i Medias dhe Drejtësisë” themeluar me vendimin me nr 7685 datë 28.01.2026 dhe në ushtrim të objektit të saj për mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së shprehjes, të drejtave të medias dhe garantimin, monitorimin e profesionit të avokatit i cili është një allkë e një sistemi drejtësie të pavarur e të paanshëm, *Njësia Bashkiake Nr 9, lagja “Don Bosko”, rruga “Muzaka”, Kulla nr 2, Zyra nr. 7, kati pare, Tiranë*

Gjergji Zefi